



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 200/2 Prot.

Tiranë, më 27.03.2015

VENDIM

Nr. 26, datë 27/03/2015

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi/Qendra “Res Publica” ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën nr. 200 Prot., datë 06.03.2015, ndaj autoritetit publik/Këshillit të Ministrave, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”. Ankuesi me anë të shkresës nr.020/13 Prot., datë 02.02.2015, ka kërkuar nga Këshilli i Ministrave “Kopje të dosjes së emërimit, dokumentet që vërtetojnë plotësimin e kritereve ligjore të emërimit në detyrën e anëtarit të komisionit të Prokurimit Publik”. Ankuesi pretendon se kërkesa e tij nuk është trajtuar sipas afatit ligjor të përcaktuar në nenin 15/1 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, nga Autoriteti Publik.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, Komisioneri pas vlerësimit të ankesës së Qendrës “Res Publica”, me Urdhrin nr.54 datë 06.03.2015, urdhëroi kryerjen e inspektimit administrativ pranë Autoritetit Publik/Këshillit të Ministrave.

Dokumenti i kërkuar, në kuptim të nenit 7 pika 1 gërma d, e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, përbën një informacion publik dhe si i tillë duhet të publikohet, në përputhje edhe me parashikimet e ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar. Në këtë këndvështrim nuk ka asnjë kufizim për aktet e emërimit.

Për aktet e tjera, ato janë pjesë e dosjes personale e cila përmban të dhëna personale dhe sensitive.

Neni 5/1/b i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, në të cilin shprehimisht citohet “...në grumbullimin (të dhënat personale) për qëllime specifike, të përcaktuara qartë, e legjitime dhe në përpunimin në përputhje me këto qëllime”, kërkon që përpunimi i të dhënave personale të administruara në dosjet personale të punonjësve të kryhet në përputhje me qëllimin për të cilin ato janë mbledhur dhe nga kategori të caktuara. Të dhënat personale të punonjësve/subjekteve të të dhënave personale, të administruara në dosjet personale janë mbledhur me qëllim rekrutimin e tyre në detyrë, për rrjedhojë përpunimi i tyre vlerësohet i

drejtë dhe i ligjshëm vetëm në përputhje me këtë qëllim.

Në këto kushte nga autoriteti publik, dokumenti i kërkuar mund të bëhet publik në rast se plotëson kriteret e mësipërme ose kur është e mundur duke kryer anonimizimin e tyre.

Në përfundim, në lidhje me ankesën e Qendrës “Res Publica”, kundër Autoritetit Publik/Këshillit të Ministrave, Komisioneri vlerëson se, ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo pranohet.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjën b) të pikës 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së Qendrës “Res Publica”, nr.200 Prot., datë 06.03.2015, kundër Autoritetit Publik/ Këshillit të Ministrave, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”.
2. Urdhërimin e Autoriteti Publik/Këshillit të Ministrave, për dhënien e informacionit.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative kompetente, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Ky vendim u dha sot në datë 27.03.2015.

